

REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nr. i Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	8301
Nr. i Faqeve Broj Stranica No. Pages	02
Data :	31.08.18
Date :	
Date :	



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nr. i Org. Org. Jedinica Org. Unit	KM-MI-01
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	745/18
Nr. i Faqeve Broj Stranica No. Pages	02
Data :	31/08/18
Date :	
Date :	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada-Government**

**Ministria e Infrastrukturës- Ministarstvo Infrastrukture- Ministry of Infrastructure**

*Kabineti i Ministrit-Kabinet Ministra-Office of the Minister*

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 93 paragrafi (4), nenit 145 paragrafit (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 52 të Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor, nenit 11 të Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, nenit 46 të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-064 për Patent Shoferi, si dhe duke u bazuar në nenin 8, paragrafi 1, pika 1.4, Shtojca 17 e Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.14/2017, nr.15/2017, 16/2017 dhe 7/2018, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për themelimin e njësitit *task force* për sigurinë e trafikut rrugor**

1. Themelohet njësiti *Task Force* i Ministrisë së Infrastrukturës (më tej "MI") për sigurinë e trafikut rrugor, i cili do të mbulojë fushat e përgjegjësive administrative të MI-së sipas ligjeve në fuqi për rrugët, rregullat e trafikut rrugor, transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, automjetet dhe patent shoferin.

Anëtarët e Njësitit *Task Force* janë:

1. Idriz Selimaj, Zv. Ministër MI, *Udhëheqës i Njësitit*;
  2. Kumbin Shala, Dr.sc (C) Komunikacioni rrugor; *anëtar i jashtëm*;
  3. Ramadan Duraku, Dr.sc Komunikacioni rrugor; *anëtar i jashtëm*;
  4. Mevlan Bixhaku, Dr. sc. Komunikacioni rrugor; *anëtar i jashtëm*;
  5. Halil Demolli, Dr. sc. (C) Komunikacioni rrugor; *anëtar i jashtëm*;
  6. Valdrin Kasumaj, Mr.sc. Komunikacioni rrugor; *anëtar i jashtëm*;
  7. Fejzullah Mustafa, Drejtor, u.d. Dep. KSKRR, MI, *anëtar*;
  8. Arsim Mulaku, Zyrtar për Kontrolla Teknike, Dep. Automjeteve, MI, *anëtar*;
  9. Emir Morina, Inxhinier i Trafikut, DMRR, MI; *anëtar*;
  10. Fatmire Stublla, Zyrtare e Transportit Rrugor, DTT, MI, *anëtare*;
  11. Zorica Bulatovic, Zyrtare e Transportit Rrugor, DTT, MI, *anëtare*;
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e njësitit janë:
    - a) Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e të gjitha rrugëve publike, neni 32 i Ligjit nr. 2003/11 për rrugët dhe Ligji nr. 03/L-120 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për rrugët.
    - b) mbikëqyrja dhe kontrolli i transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, sipas nenit 52 Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor dhe aktet nënligjore në fuqi; dhe mbikëqyrja e transportit tokësor të transportit të mallrave të rrezikshme, neni 52 Ligji nr. 04/L-183 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme dhe aktet nënligjore në fuqi;

c) mbikëqyrja e sigurisë rrugore në pajtim me nenin 11 të Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor dhe aktet nënligjore në fuqi;

d) mbikëqyrja dhe kontrolli i punës së Qendrave të Kontrollimit Teknik të Automjeteve sipas nenit 46, Ligji nr. 05/L-132 për Automjete dhe aktet nënligjore në fuqi. Në kuadër të kësaj detyre njësitit autorizohet te:

- ndaloj dhe dërgoj në kontrollë të jashtëzakonshme teknike të gjitha automjetet të cilat kanë mangësi të dukshme të gjendjes së tyre teknike, në pajtim me nenin 106 të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete;

- ndaloj të gjitha automjetet të cilat duhet t'i nënshtrohen kontrollit periodik të gjendjes teknike në pajtim me nenin 77 të Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete;

- ndaloj të gjitha automjetet e angazhuara në aftësimin e kandidatëve për drejtim të automjetit sipas nenit 49 të Ligjit nr.05/L-064 për Patent Shoferi dhe aktet nënligjore në fuqi;

3. Njësitit do të bashkëveproj gjatë gjithë kohës me inspektorët përkatës të Ministrisë së Infrastrukturës, zyrtarët policor të Policisë së Trafikut dhe sipas nevojës me zyrtarë tjerë të ministrive përkatëse.
4. Departamenti i Inspektimit, është i obliguar që të përshtatë planin e punës sipas kërkesave të udhëheqësit të njësitit.
5. Anëtarët e njësitit do t'i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sipas këtij vendimi në bazë të planit të punës të udhëheqësit të njësitit. Udhëheqësi i njësitit do t'i raportoj drejtpërdrejt Ministrit për punën e njësitit një herë në javë.
6. Në afat prej 60 ditësh nga fillimi i ushtrimit të detyrave, Njësitit do të dorëzoj propozim për masa konkrete (përmirësim të bazës ligjore, marrjen e masave administrative) me qëllim të rritjes së sigurisë në trafikun rrugor.
7. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që të siguroj automjete dhe paisje pune për anëtarët e njësitit si dhe të caktoj kompenzimin mujor për anëtarët e jashtëm të njësitit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
8. Mandati i njësitit fillon nga data 1 shtator 2018 dhe zgjatë deri në një vendim tjetër të Ministrit.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Pal Lekaj**  
Ministër



**Iu dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të njësitit;
- Ministrisë për Punë të Brendshme
- Policisë së Kosovës;
- Ministrisë së Shëndetësisë;
- Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Të gjitha Departamenteve të MI-së;
- Arkivit të MI